Me fillimin e implementimit të projektit “Zhvillimi i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” dhe me ndryshimin e Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal, këto punëtori planifikuese u rriten në forume rajonale në pajtueshmëri me rregullat e Agjencionit Zvicëran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe BNJVL. Në forum u angazhua moderator me serti fikat të lëshuar nga BNJVL dhe në pajtueshmëri me rregulloren, ftesa dhe rendi i ditës u dërgua deri tek të gjithë palët e interesuara në rajon. U organizuan dy cikle me nga dy sesione të forumit me numër të përcaktuar të tavolinave punuese sipas fushave prioritare. Në sesionin e parë u identifikuan problemet dhe për të njëjtat u gjeten zgjidhje. U formuan grupe punuese të cilat punuan për konceptet e projekteve të propozuara dhe të njëjtat u prezantuan para pjesëmarrësve në sesionin e dytë të forumit. Në sesionin e dytë të gjithë pjesëmarrësit me të drejt vote dhe me atë u krijua lista e projekteve prioritare për rajonin.

Në të dy ciklet e forumit morën pjesë gjithsej 209 pjesëmarrës nga të cilat 113 janë femra dhe 96 meshkuj. Numri mesatar i pjesëmarrjes në forume është 52 pjesëmarrës nga të cilët 28 janë femra dhe 24 meshkuj, ose e treguar me përqindje 54% nga pjesëmarrësit janë femra dhe 46% janë meshkuj. Sipas strukturës etnike 64% e pjesëmarrësve në forume janë maqedonas, 25% shqiptar, 6% turq, 4% vllah dh 1% të tjerë. Në lidhje me grupet e rrezikuara përfaqësimi i tyre është 4% nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, ndërsa të rinjtë ishin të përfaqësuar me 20% nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve.

Siç është theksuar në fillim, Qendra për zhvillim e RPJP në vazhdimësi përdor mjete participative siç janë punëtorit planifikuese dhe viteve të fundit në formë të forumeve rajonale, në të cilat propozohen dhe zgjidhen projekte prioritare. Të gjithë projektet e zgjedhura dhe të realizuara janë në pajtueshmëri me Programin për zhvillim të rajonit, dhe mundet lirisht të thuhet se të gjithë janë zgjedhura përmes punëtorive planifikuese dhe forumet, gjegjësisht me një konsultim të gjerë me të gjithë palët e interesuara.

#### **4. Sigurimi i përfshirjes sociale në realizim të Programit**

Në këtë pjesë janë paraqitur vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për kontributin dhe rezultatet e arritura në fushën e përfshirjes sociale në zbatimin e Programit për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Në të gjitha projektet e realizuara rajonale, është marrë parasysh përfshirja sociale e grupeve vulnerabël të qytetarëve.

Aktivitetet e Qendrës së biznesit janë në dispozicion për të gjitha kategoritë e qytetarëve, duke përfshirë edhe kategoritë e rrezikuara. Gjatë publikimit të mundësive për financim të sektorit të biznesit, sesioneve informative, mbështetjes mentoruese për thirrjet e FIZHT-it, kampeve të

inovacionit, njoftimeve në FB, etj., Qendra për zhvillim u drejtohet të gjithë aktorëve në sektorin e biznesit, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, prindërit e vetëm, të papunësuarin për një periudhë afatgjatë, njerëz që punojnë në ekonominë e zezë dhe të gjithë të tjerët që janë me rrezik social.

Projektet rajonale, masat për zbatimin përfshijnë përmirësime në infrastrukturën komunale, trajtojnë gjithashtu përfshirjen sociale të komuniteteve lokale dhe nga zonat urbane dhe rurale. Gjithashtu është bërë lidhje ekonomike mes personave të izoluar në zonat rurale nëpërmjet ndërtimit të rrugëve të aksesueshme në tokën e punëshme.

Trajnimi për fuqizimin e aftësive tek të punësuarit në Qendër, për transparencën përmes përmirësimit të sistemit të komunikimit përmes rrjeteve sociale, gjithashtu krijohet mundësia për qasje më të madhe tek informacioni për të gjithë kategoritë e qytetarëve duke i përfshi edhe grupet e rrezikuara.

Me realizimin e projektit “Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike dhe zvogëlimin e ndotjes në ambientin jetësor në RPJP” ndër aktivitetet më të rëndësishme të realizuara është rekonstrukcioni i 11 apartamenteve të OJQ Mobilnost, ku anëtarë janë 8000 e saj me aftësi të kufizuar fizike. Rekonstrukcioni i apartamenteve u realizua deri ka mesi i muajt maj 2022, prej periudhës nga majo deri në tetor 2022 janë mundësi për rekreacion rreth 400 persona me invaliditet fizik.

Me realizimin e të gjitha aktiviteteve në kuadër të projekteve rajonale janë krijuar mundësit për përmirësimin e kushteve për të gjithë kategoritë duke i përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar, fëmijët të izoluar nga zonat rurale, persona që i përkasin komunitetit dhe persona të tjerë që kanë rrezik social.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti i përfshirjes sociale në zbatimin e secilit projekt ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

<b>Nr. rend</b>	<b>Projekt / aktivitete</b>	<b>Komponenti për inkluzion social</b>	<b>Indikator/e</b>
<b>1.</b>	Përkrahja e zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive të tjera ekonomike	Lidhje ekonomike me personat e izoluar në zona urbane dhe rurale	350 persona nga zona urbane (Ohri, Struga) rurale (Qendër Zhup dhe Vevçani)
<b>2.</b>	Biznes qendra	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar, prindër të vetushqyes, persona të pa punësuar për që periudhë të gjatë, persona që punojnë në tregun e zi dhe të tjerë me rrezik social	175 persona të përfshirë me rrezik social
<b>3.</b>	EE i përmirësuar në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar fizike nga OJQ Mobilnost, persona të moshuar, persona me rrezik social	400 anëtar të OJQ Mobilnost, 100 persona të moshuar dhe persona me rrezik social

4.	Forumet rajonale	Përfshirja e personave të moshuar me aftësi të kufizuar, personat e izoluar nga zonat rurale, personat që për një kohë të gjatë janë të pa punë, përfaqësuesit nga komunitetet	Mesatarisht 52 pjesëmarrës në forume, 64% Maqedonas, 25% shqiptarë, 6% turq, 4% vllleh dhe 1% të tjerë, 4 % pjesëmarrës nga grupet e rrezikuara dhe 20% të rinjë
5.	Trajnim për smart specializimi dhe komunikimi efektiv	Përfshirja e përfaqësuesve nga komuniteti, persona të rritur me aftësi të kufizuar, persona të izoluar nga zonat rurale	Mesatarisht 20 persona në trajnim, 60% maqedonas, 30% shqiptarë, 10 të tjerë, 1% persona të rritur me aftësi të kufizuar dhe 1% persona nga zona të izoluar
6.	Trajnim për përdorimin e metodave për fuqizimin e transparencës dhe përgjegjësisë, përmes përdorimit të rrjeteve sociale	Përfshirja e personave të moshuar me aftësi të kufizuar, personat e izoluar nga zonat rurale, personat që për një kohë të gjatë janë të pa punë, përfaqësuesit nga komunitetet	2007 ndjekës në FB profilin në rrjetet sociale nga të cilët 2% janë nga grupet e caktuara për inkluzion social

## 5. Sigurimi i barazisë gjinore në realizimin e Programit

Në këtë pjesë është prezantuar vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për progresin e arritur dhe rezultatet e arritura në pjesën e barazisë gjinore në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, me theks të veçantë për përgjegjësin buxhetore gjinore.

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor viti 2021 -2026, në pjesën e barazisë gjinore dhe përgjegjësi gjinore buxhetore, është përgatitur në pajtueshmëri me konventen ndërkombëtare të pranuar dhe dokumentet që janë miratuar në vend, duke e marr parasysh Strategjinë për barazi gjinore në RMV. Gjithashtu, gjatë përcaktimit të qëllimeve strategjike, prioriteteve dhe masave është marr parasysh parimi për realizimin e mundësive të barabarta, gjegjësisht mundësimi i meshkujve dhe grave të marrin pjesë në planifikimin dhe krijimin e aktiviteteve kryesore në Rajon, përmes punës së Këshillit dhe Qendrës për zhvillim, si dhe përmes angazhimit të palëve të tjera të interesuara në nivel lokal - Komuna, akademia, sektori i biznesit dhe OJQtë. Gjithashtu, janë marr parasysh dhe parimet për status dhe tretman të njëjtë në realizimin e të drejtave të tyre, si dhe barazi në shfrytëzimin e përfitimeve/efekteve nga rezultatet e arritura nga projekti.

Dhe nga këndi i buxheti mit të projekteve, dhe pjesa e aktiviteteve të planifikuara, u shpreh dëshira e barazisë gjinore, përmes organizimit të forumeve rajonale me zbatimin të praktikave e pjesmarrjes në procesin e buxheti mit. Kjo dmth se janë marr parasysh dallimet gjinore, nevojat dhe interesat në sektorët në të cilat implementohen projektet: infrastruktura rrugore, bujqësia, arsimit, mbrojtja sociale dhe në sektorin e biznesit. Është e rëndësishme të përmendet se në të gjitha aktivitet etet që i

organizon Qendra për zhvillim e RPJP numri i femrave pjesëmarrëse është më i lartë se numri i meshkujve.

Me aktivitetet e realizuara, rezultate domethënëse (përmes të dhënave/indiktorët e matshëm të pasqyruara në tabelen e më poshtme) janë arritur në:

- barazi gjinore në sektorin në të gjitha sektorët, nxitja/zmadhimi i roli të grave dhe të rinjve në menaxhimin e veprimtarive ekonomike, në veçanti në bizneset familjare që janë të lidhura me këtë sektor,

- Janë arritur rezultate të rëndësishme në avancimin e procesit arsimor dhe sferës sociale me mundësinë e qasjes më të lehtë për të gjithë nxënësit (pa dallim gjinie, etnike, sociale apo përkatësi tjetër), dhe për stafin arsimor, si dhe në tejkalimin e disproporcioneve të përdoruesve të shërbimeve sociale, dhe

- Sigurimi i aksesit më të lehtë deri tek burimet e financimit për biznes ideve të popullatës femërore, nëpërmjet trajnimeve për përgatitjen e planeve të biznesit dhe aplikacioneve të projekteve konkrete (FIZHT, Horizon 2020...) dhe inkurajimit të sipërmarrjes femërore.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti i barazisë gjinore gjatë zbatimit të projekt të veçantë ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt / aktivitet	Komponenta për barazi gjinore	Indikator/e
1.	Përkrahja e zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive të tjera ekonomike	Mundësi të barabarta për shfrytëzimin e infrastrukturës rrugore për të gjithë gjinitë në bashkësi	Numër: 3266m rrugë të re konstruktuar, 2270m <sup>2</sup> trotuare, 500m kanalizim atmosferik  Vlerësimi: Krijimi i kushteve për zhvillimin e biznesit familjar duke i përfshirë të gjithë anëtarët të amvisëria
2.	Aktivitetet e Biznes qendrës	Krijimi i kushteve për mundësi të barabarta për të gjitha kategoritë gjinore në veçanti për grupet sociale të shkyçura (grupet e rrezikuara, personat nga zonat rurale, persona me aftësi të kufizuar, persona të përfshirë në tregun e zi të punës...), si dhe të rinjve dhe grave dhe përfshirja e tyre në sektorin e biznesit	Numër: 200 persona të përfshirë në aktivitetet e biznes qendrës  Vlerësimi: U mundësuan përfshirja në tregun e punës dhe hapja e mundësive për zhvillim të sipërmarrjes në veçanti për grupet qëllimore.
3.	EE i përmirësuar në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Krijimi i kushteve për mundësi të barabarta për të gjitha kategoritë gjinore në veçanti në sferën e arsimit dhe sferën sociale	Numri: Përmirësimi i kushteve për qëndrim në institucionet të sferës arsimore dhe sociale për 130 persona me nevojë të

			veçanta, 20 persona të pamundur, 150 fëmijë dhe të rritur të izoluar në zona rurale dhe 8000 persona me aftësi të kufizuara fizike Vlerësimi: krijimi i kushteve për qasje të barabartë në sferën arsimore dhe sociale përmes përmirësimit të kushteve të dhënies/marrjes së shërbimeve për të gjitha gjinitë
4.	Forumet rajonale	Krijimi i kushteve për mundësi të barabartë për të gjithë kategoritë gjinore	207 pjesëmarrës në forumet rajonale, nga të cilat 113 femra dhe 96 meshkuj
5	Trajnim për smart specializimi dhe komunikimi efektiv	Mundësi të barabarta për përfshirjen të të gjitha kategorive gjinore	40 pjesëmarrës në trajnim , prej të cilave 25 janë femra dhe 15 meshkuj
6	Trajnim për përdorimin e metodave për fuqizimin e transparencës dhe përgjegjësisë, përmes përdorimit të rrjeteve sociale	Krijimi i kushteve për mundësi të barabartë për të gjitha kategoritë gjinore	2007 ndjekës në FB profilin e Qendrës për zhvillim nga të cilët % më e madhe janë femra

## 6. Kontribut kah mbrojtja e ambientit jetësor gjatë realizimit të Programit

Në këtë pjesë është prezantuar vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për progresin e arritur dhe rezultatet e arritura në pjesën e mbrojtjes dhe avancimin e ambientit jetësor në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Në të gjitha projektet rajonale të realizuara i kushtohet vëmendje mbrojtjes së ambientit jetësor. Gjatë realizimit të projektit rajonal "Përmirësimi i zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive të tjera ekonomike" masat për implementim përfshin infrastrukturën komunale, gjatë realizimit të punëve u respektuan të gjitha standardet dhe masat për të mbas ndikim negativ mbi ambientin jetësor, në pajtueshmëri me Ligjin për ndërtim dhe të gjitha rregulloret e tjera për organizimin e ndërtimit. Është e rëndësishme të theksohet se është shfrytëzuar i njëjti gur dhe vetëm guri i dëmtuar është ndryshuar dhe është venduar i ri, për çka ka të bëjë me mbrojtjen e ambientit jetësor për shkak se përdoren materiale natyrore dhe njëkohësisht ruhet autenticiteti i rrugëve.

Aktivitetet e Qendrës së Biznesit nuk kanë ndikim negativ në ambientin jetësor duke pasur parasysh natyrën e tyre. Domethënë, publikimi i informacionit, sesionet informative, mbështetja mentoruese për thirrjet e FIZHT-ke, kampet e inovacionit që u zhvilluan Online, njoftimet në FB, etj., nuk kanë asnjë

ndikim negativ mbi ambientin jetësor. Kompanitë të cilat u mentoruan për aplikimin në FIZHT u është sugjeruar se gjatë realizimi it të aktiviteteve të kenë parasysh ruajtjen e ambientit jetësor.

Me realizimin e projektit “Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike dhe zvogëlimin e ndotjes së ambientit jetësor në RPJP” janë implementuar masat për efikasitet energjetik gjatë rekonstruksionit të objekteve publike (11 apartamenteve të OJQ Mobilnost, shtëpia me karakter kuluro – historik në Trebenishtë). Gjithashtu të gjitha aktivitetet ndërtimore nuk kanë ndikim negativ mbi ambientin jetësor, janë respektuar të gjitha standardet dhe masat për tejkalimin e ndikimit mbi ambientin jetësore sipas Ligjit për ndërtim dhe të gjitha rregulloreve për organizimin e ndërtimit. Për Komunën e Pllasnicës janë blerë 59 kontejner dhe 258 kosha për grumbullimin e mbeturinave e cila është pjesë e masave për mbrojtjen e ambientit jetësor. Rekonstruksioni i kanalit të Pesjak në MakedonskiBrod i grumbullon dhe i kanalizon ujërat e zeza. Edhe këto aktivitete kanë ndikim të madhe në mbrojtjen e ambientit jetësor në rajon planor Jugperëndimor.

Forumet rajonale, përkthimi i Programit ë gjuhës shqipe dhe Trajnimi për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të Qendrës për zhvillimin të RPJP për transparencë duke përmirësuar sistemin e komunikimit përmes rrjeteve sociale, nuk kanë ndikim negativ mbi ambientin jetësor.

Gjatë realizimit të projekteve rajonale, masat për realizim përfshijnë përmirësime në infrastrukturën komunale, gjatë kryerjes së punëve janë respektuar të gjitha standardet dhe masat për shmangien e ndikimeve negative në ambientin jetësor sipas Ligjit për ndërtim dhe të gjitha rregulloreve për organizimin e ndërtimit.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti mbrojtja dhe avancimi i ambientit jetësor gjatë zbatimit të projekteve të veçanta ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt/ aktivitete	Komponenta për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	Indikator/e
1.	Përkrahja e zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive të tjera ekonomike	Pastrimi i terrenit, rrërimi, tamponimi dhe gurë të bluar natyror, përdorimi i materialeve që nuk janë të rrezikshme për ambientin jetësor	Kualiteti i tokës, ajarit dhe ujit, nuk ka të dhëna nga matjet
2.	Aktivitetet e Biznes qendra	Shkresa, takime online, mentorimonline	Me të gjithë llojet e komunikimit me biznes sektorin u është sugjeruar të zbatojnë masa të cilat e mbrojnë ambientin jetësor gjatë përgatitjes dhe realizimit të projekteve inovative. Nuk ka të dhëna nga matjet

3.	EE i përmirësuar në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Veprimtari ndërtimore, instalim temo – teknik, instalim elektrik në pajtueshmëri me masat dhe standardet për tejkalimin e ndikimit negativ mbi ambientin jetësor, furnizimi me kontejner dhe kosha për grumbullimin e mbeturinave, grumbullimi dhe kanalizimi i ujërave të zeza dhe atyre atmosferik	Kualiteti i tokës, ajarit dhe ujit, nuk ka të dhëna nga matjet
4.	Forumet rajonale	Nuk ka komponentë për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	/
5.	Trajnim për smart specializimi dhe komunikimi efektiv	Nuk ka komponent për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	/
6.	Trajnim për përdorimin e metodave për fuqizimin e transparencës dhe përgjegjësisë, përmes përdorimit të rrjeteve sociale	Nuk ka komponent për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	/

## 7. Kontributi kah digjitalizimi në realizimin e Programit

Në këtë pjesë është prezantuar vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për progresin e arritur dhe rezultatet e arritura në pjesën e digjitalizimit në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Shumica e aktiviteteve të Biznes Qendrës u realizuan Online, siç janë info sesionet, mentorimi dhe kapet e inovacionit. Gjithashtu publikimet në WEB faqen e Qendrës dhe FB profilit për mundësit e Sektorit të biznesit janë pjesë e shërbimeve digjitale. Gjithashtu për 5 sipërmarrës të suksesshëm nga rajoni u përgatiten 5 video klipepromovuese të cilat u publikuan në FB profilin dhe YouTube kanalin e Qendrës. Përveç kësaj në vazhdimësi gjatë vitit 2022 u bë azhurimi i listës të potencialeve qeveritare dhe mundësive të tjera financiare për mbështetjen e biznes sektorit, azhurimin e- bazës të institucioneve dhe ndërmarrjeve të cilat ofrojnë shërbime zhvillimore për sektorin privat dhe shpërndarja e rregullt e informacioneve deri tek mediumet lokale dhe rajonale.

Forumet rajonale, trajnimi për smar specializimin. Komunikimi efektiv dhe trajnimi për fuqizimin e kapaciteteve tel të të punësuarit të Qendrës për zhvillimin të RPJP për transparencë duke përmirësuar sistemin e komunikimit përmes rrjeteve sociale, kanë komponent të digjitalizimit. Komunikimi me pjesëmarrësit në forumet rajonale u realizua përmes rrugës elektronike. Programi i përkthyer në gjuhën shqipe në formë digjitale u publikua në WEB faqen e qendrës. Trajnim në vetvete jep mundësia përmes rrjeteve sociale përmes rrugës digjitale të shpërndahen informacione deri tek të gjithë palët e interesuara.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti e digjitalizimit gjatë

zbatimit të projekteve të veçanta ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt/ aktivitet	Komponeta e digjitalizimit	Indikator/e
1.	Përkrahja e zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtarive të tjera ekonomike	Nuk ka komponent për digjitalizim	Nuk ka të dhëna
2.	Aktivitetet e Biznis qendra	Takime informative online, mentorimi, kamp inovacion (GoogleMeet, Zoom), dërgimi i informacioneve përmes emailit, përgatitja e video klipevepromovuese për sipërmarrje të suksesshme nga rajoni ,publikime dhe shpërndarje në FB dhe YOuTube kanal in e Qendrës, azhurimi i e bazës të të dhënave, lista me burime për financim	5 sesione informative online për thirrjet nga FIZHT  13 ndërmarrje të mentoruaronline për thirrjet e FIZHT Pjesëmarrjee 30 personave në takime online Pjesëmarrje në 2 kampe inovativeonline, 5 video klime te publikuara, 22 publikime në FB, 2007 mbështetës në FB
3.	EE i përmirësuar në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Nuk ka komponent për digjitalizim	Nuk ka të dhëna
4.	Forumet rajonale	Komunikimi me pjesëmarrësit në form elektronike	Ftesa të dorëzuara dhe materijale deri tek 100 përfaqësuesit nga rajonit
5	Trajnim për smart specializimi dhe komunikimi efektiv	Komunikimi me pjesëmarrësit përmes postës elektronike	Ftesa të dorëzuara dhe materiale deri tek 50 përfaqësuesit nga rajonit
6	Trajnim për përdorimin e metodave për fuqizimin e transparencës dhe përgjegjësisë, përmes përdorimit të rrjeteve sociale	Komunikim në rrjete sociale përmes formës digjitale	Janë publikuara 537 informacione në rrjetet sociale, janë publikuar 58 informacione në WEB faqen e Qendrës



## 8. Raporti për punën financiar të Qendrës për zhvillim të rajonit planor

Në raportin financiar janë paraqitur të dhënat nga dy kontot e Qendrës për zhvillim, e cila njëra është bazike dhe njëra nënkonto e cila është hapur për projektin e donatorit.

Në periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022 janë realizuar të ardhura në vlerë të përgjithshme prej 143.728.458 denarë, prej të cilave 142.529.308 denarë në konton bazike të Qendrës, ndërsa nënkontoja për projektin e donatorit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv faza e II,“ në shumën prej 1.199.150 denarë. Realizimi procentual i të ardhurave është 113,51 % nga të ardhurat e parapara në Planin financiar për vitin 2023.

Në vitin 2022 janë realizuar shpenzime në shumën totale prej 59.004.419 denarë, prej të cilave në konton bazë 57.925.418 denarë, ndërsa nga nënkontoja e donatorit 1.079.001 denarë. Shpenzimet kapitale gjegjësisht aktivitetet e projektit në kuadër të projekteve rajonale janë siguruar në vitin 2021 dhe 2022 nga buxheti dhe burimet nga donatorët, janë harxhuar 53.303.400 denarë ose 90.34% nga shpenzimet e përgjithshme për vitin 2022.

Në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet buxheteve dhe shfrytëzuesve të buxhetit në tërësi është zbatuar principi i pajtueshmërisë të obligimeve të marra dhe pagimi i të njëjtave gjatë vitit buxhetor aktual, ashtu që Qendra nuk ka obligime të bartura në vitin 2022. Qendra për zhvillim për obligimet krijuara gjatë punës, projektete e realizuara gjatë vitit 2022 dhe obligimet prej projektit të donatorit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv faza e II,“ arriti që para mbylljes së thesarit të mbuloj në tërësi. Kanë ngelur vetëm obligimet të cilat janë bartur për vitin në vijim në vlerë prej 142.528 denar prej të cilave në konton bazike janë 12.528 denar ndërsa nga kontoja e projektit janë 130.000 denar, dhe të njëjtat janë paguar në fillim të vitit 2023.

Në pajtueshmëri me evidencën e kontabilitetit, detyrimet e përgjithshme në datën 31.12.2022 janë 5.969.897 denarë. Në këtë shumë janë të përlogaritura detyrimet nga borxhi i vjetër i Komunave për punën e Qendrës në vlerë prej 5.927.046 denar dhe 42.851 denar nga projekti me donator.

Në periudhën e raportimit Qendra për zhvillim përgatiti dhe realizoi 23 furnizime publike. Nga të cilat 16 furnizime u realizuan përmes Sistemit elektronik për furnizime publike në pajtueshmëri me Ligjin për furnizime publike, ndërsa 7 furnizime publike u realizuan në pajtueshmëri me Rregulloren e donatorit për realizimin e pjesëve të veçanta të projektit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv – faza e 2“, i financuar nga Agjencioni Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria për vetëqeverisje lokale.

Raporti i përgjithshëm për punën financiare, i cili është pjesë përbërëse nga Raporti Vjetor, në pajtueshmëri me nenin 32 paragrafi 2 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, është dorëzuar si Aneks 1 në fund të Raporti Vjetor.

## 9. Organizimi dhe menaxhimi

Të punësuarit e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor i kryejnë punët që janë në kompetencën e Qendrës dhe bëjnë punë profesionale për Këshillin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Gjatë vitit 2022 në Qendër ishin të punësuar 5 persona, prej të cilëve Drejtori, 3 Koordinator rajonal dhe një Administratori. Nga numëri i përgjithshëm të personave të angazhuar në Qendër 3 janë femra dhe 2 janë meshkuj.

Të gjithë të punësuarit në Qendër janë me arsim të lartë. Drejtori i Qendrës është elektroinxhinier i diplomuar dhe Magjistër për zhvillim të barabart lokal dhe rajonal, dhe është me marrëveshje për afat të caktuar kohor prej 4 viteve.

Koordinatorët janë: njëri është politiko log i diplomuar, një ekonomistë dhe një është i diplomuar në administrimin e biznesit, dhe janë me marrëveshje me afat të papërcaktuar. Administratori është jurist i diplomuar dhe është me marrëveshje në afat të caktuar kohor.

Gjatë periudhës së raportimit të punësuarit e Qendrës kanë marr pjesë në disa trajnime të cilat janë të rëndësishme për punën e Qendrës. Gjergjisht, dy të punësuarit morën pjesë në trajnimin për barazi gjinore e organizuar nga UNDP. Tre të punësuar morën pjesë në konferencën shkencore “ Sfidat e mësuara për zhvillim të qëndrueshëm e organizuar nga Universiteti Ndërkombëtar – Strugë”. Dy të punësuar në punëtorin me menaxhimin me mbeturinat dhe zhvillimi i ekonomisë lokale në organizim nga TAIEK LTA dhe Qendra për zhvillim e rajonit planor të Shkupit. Dy nga të punësuarit e ndoqën trajnimin për përdorimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të metodave për fuqizimin e transparencës dhe përgjegjësisë përmes përdorimit të rrjeteve sociale e cila u mbajt në Manastirëbashkërisht me të punësuarit e Qendrës të tjera planore. Një nga të punësuarit online e ndoqi trajnimin për portalet elektronike të Agjencioni për mbrojtje dhe të drejtën në qasje në informacion me karakter publik.

Këshilli për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor mbajti 6 seanca gjatë vitit 2022. Nga ana e Këshillit për zhvillim u shqyrtuan dhe u miratuan Raporti vjetor për realizimin e programit për zhvillim të RPJP në vitin 2021, Raporti vjetor për punën e Qendrës për vitin 2021, Raporti vjetor financiar dhe llogaria vjetore për 2021, Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026 (me pajtueshmëri të më parshme me Këshillin për zhvillim të barabartë rajonal në RMV), plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të RPJP për vitin 2022. Listën prioritete për projekte rajonale për vitin 2022-2023, Planin financiar për vitin 2023 dhe Planin aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të RPJP në 2023. Gjatë vitit 2022 anëtarët e Këshillit për zhvillim u informuan nga ana e përfaqësuesve të Qendrës për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor për metodologjinë e përpunimit të Planeve hapësinor në RMV. Gjithashtu përfaqësues nga Zyra projektues për realizimin e projektit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv faza e II,, dhe eksperti nga Sllovenia realizuan takim me anëtarët e Këshillit për zhvillim të RPJP, ku u bisedua për organizimin e një udhëtimi studimor në një vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Përfaqësues nga PAKOMAK në seancën e Këshillit për zhvillimit RPJP i informoj kryetarët e komunave për mundësin e pjesëmarrjen në projektin për furnizimin me makina vending për mbeturinat plastike.

## **10. Propozime dhe sugjerime deri tek palët kyçe për politikat të zhvillimit të barabartë rajonal**

Në këtë pjesë janë paraqitur propozimet dhe sugjerime konkrete për përmirësimin dhe avancimin e zbatimit të Programit të zhvillimit rajonal. Propozimet dhe sugjerimet dalin nga përvojat e Qendrës në përgatitjen e aplikacioneve dhe kriteret e aplikimit, zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe vlerësimin e projekteve dhe kanë të bëjnë me përmirësimin dhe avancimin e punës në proceset e dhëna.

Propozime dhe sugjerime për Këshillin për zhvillim të barabart rajonal

Këshilli për zhvillim të barabartë rajonal të RMV të takohet më shumë herë gjatë vitit me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve. Vendimet me listat e propozuara për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore, të merren në fillim të vitit dhe të përcillen për miratim në Qeverinë e RMV-të. Në këtë mënyrë Qendrat për Zhvillim të rajoneve planore do të mund të fillojnë me kohë me realizimin e projekteve rajonale dhe të realizohen me sukses dhe në mënyrë cilësore aktivitetet e projektit brenda afateve të përcaktuara.

## Propozime dhe sugjerime deri tek Ministria për vetëqeverisje lokale

Nga eksperiencia e deri tanishme Qendrat për zhvillim nuk ishin të përfshira gjatë përgatitjes për ndryshimin e ligjit, nënligjeve akteve dhe rregullovet. Nga këtu i rekomandohet Ministrisë që të jenë më transport dhe ti zbatojn principet e participimiti, me çka do ti konsultojn Qendrat për zhvillim të rajoneve planore, për zgjidhjen ligjore dhe akteve nënëgjore duke marr për bazë formimin dhe funksionimin e Qendrave.

Në kuadër të Ministrisë për vetëqeverisje lokale ekziston Sektor për zhvillim rajonaë, i cili me të drejt duhet të ketë komunikim direkt me Qendrat për zhvillim të rajoneve planore. Gjatë viteve të fundit Sektori për zhvillim rajonal aspak nuk komunikon me Qendrat dhe gjithashtu nuk mund të vërehet se kz sektor po funksionon. Roli i tij është marr nga na e Njesis së projektit për implementimin e projektit „Zhvillim i barabart rajonal i qendrueshëm dhe inkluziv faza e II,„. Rekomandojmë si sektori ashtu edhe njësia e projektit të punojnë në kuadër të kompetencave të tyre.

Për realizimin e aktiviteteve në kuadër të projektit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv faza e II,„, u përgatit kalendar me dinamikën e aktiviteteve i cili në periudhën prill – maj 2022 i vendosi në pozicion që Qendra për zhvillim në të njëjtën kohë të organizoj shumë evenimente edhe për mjetet nga Programi për ZHBR 2022/2023. Edhe për shkak të afatit të shkurtër kohor Qendra i përmbushi të gjitha obligimet siç ishin paraparë ë dinamikë. Por fatkeqësisht kjo dinamik nuk u respektua nga ana e Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Njesisë së projektit ZHBQI, ashtu që në vend të korrik të vitit 2022 marrëveshjet për realizimin e projekteve u nënshkruan në mes të dhjetorit 2022. Rekomandojmë deri tek Ministria për vetëqeverisje lokale që ta respektoj dinamikën e aktiviteteve të përcaktuara.

## Propozime dhe sugjerime deri tek Byroja për zhvillim rajonal

Me Byron për zhvillim rajonal Qendrat kanë komunikim dhe bashkëpunim të mirë. Rekomandojmë që të vazhdoj komunikimi dhe bashkëpunimi i rregullt dhe të thellohet me qëllim që të arrihen rezultate më të mira.

## Propozime dhe sugjerime deri tek ministritë linore në drejtim për realizimin e Programeve të resoreve të veçanta

Ministrive të tjera u rekomandojmë që të jenë më aktive në Këshillin për zhvillim të barabartë rajonal në RMV. Gjithashtu, rekomandojmë gjatë ndarjes së mjeteve për financimin e projekteve ti dimensionojnë në pajtueshmëri me shkallën e zhvillimit të rajoneve planore. Të gjithë ministrit e tjera tu japin mundësi Qendrave për zhvillim të rajoneve planore që të mund të aplikojnë të thirrjet për financimin e projekteve.

## Propozime dhe sugjerime deri tek Këshillat e Komunave të rajonit planor

Edhe pse Këshillat e komunave kanë mandatin prej tetori 2021, rekomandojmë takime me këshilltarët me çka do ti prezantonim politikën e zhvillimit rajonal, mundësit dhe aktivitetet të cilat i realizojnë Qendrat për zhvillim. Me këtë , njohja më së afërmi me këshilltarët do të nxisë bashkëpunimin më të

mirë dhe shkëmbimin e ideve për zgjedhjen e problemeve të komunave dhe bashkimin e më shumë Komunave nga rajoni planor Jugperëndimor përmes projekteve rajonale.

## II. PJESA TABELARE E RAPORTIT VJETOR

Pjesa tabelare e raporti vjetor i përmban përbërjen e më poshtme:

### A. Pasqyrim tabelar për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve në funksion të realizimit të Programit për zhvillim të rajonit, ku bartëse është Qendra për zhvillim të rajonit planor

Këtu përfshihen të gjitha projektet, pa marrë parasysh burimet dhe programet e financimit, ku bartës është Qendra për Zhvillimin e rajonit planor: nga Programi për zhvillim rajonal të MVL dhe BZHR; nga buxhetet e Komunave të rajonit; Programi për subvencione kapitale për zhvillimin të rajoneve planore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural të MBPU-të; Programi për Mbështetjen Financiare për Zhvillimin Rural AFMZHR; programi APPRSM; programet e BE-së; Programet e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje; Programe nga burime ndërkombëtare financimi.

### B. Pasqyrim tabelar për realizimin e të gjitha projekteve gjatë vitit raportues në funksionin për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit, ku bartëse është Qendra për zhvillim të rajonit planor

Këtu përfshihen të gjitha projektet e për investimet publike në rajon, qofshin ata buxhetore ose jashtë buxhetit, përkatësisht, përveç ministrive të tjera dhe komunat, këtu janë edhe projektet e ndërmarrjeve publike, fondet dhe shoqëritë aksionare me pronësi dominonte shtetërore. Të dhënat për këtë pasqyrë tabelare Qendra i marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes kontakteve na aktorët e përmendur, si dhe nga Sistemi elektronik për koordinim dhe planifikimi, realizimi, monitorimi dhe vlerësimi i politikave për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

### C. Pasqyrim tabelar për realizimin e të gjithë investimeve private në rajonin planor gjatë vitit raportues

Të dhënat për këtë pasqyrë tabelare Qendrat i kanë marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes kontakteve me subjektet afariste në rajonin planor, nga odat ekonomike rajonale, si dhe nga aktivitetet e Biznes Qendrës.

### D. Pasqyrim tablera për numrin dhe përmbajtjen e aktiviteteve të realizuara për sigurimin e transparencës në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor gjatë vitit raportues

Të dhënat për këtë pasqyrë tabelare Qendrat i kanë marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke menaxhuar me projektet ku janë bartës në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor.

**A. PASQYRIMI TABELAR PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE NGA PROJEKTET NË VITIN RAPORTUES NË FUNKSION PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR PËR VITIN 2021-2026, KU BARTËS ËSHTË QENDRA PËR ZHVILLIM E RAJONIT PLANOR**

(Tabela është përshtatur në pajtueshmëri me numrin e qëllimeve strategjike të definuara, numrin e prioriteteve të definuara në kuadër të qëllimeve strategjike, numri i masave të definuara në kuadër të çdo prioriteti të definuar dhe numri i aktiviteteve të projektit për çdo masë të definuar, në pajtueshmëri me Programin për zhvillim të rajonit planor 2021-2026 të përcaktuar)

Qëllimi strategjik 1 – Avancimi i ekonomisë dhe paritetin gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive krahasimore të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji të reja, njohuri dhe inovacion, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësi dhe zhvillim rural.								
MASA	PROJEKT/ AKTIVITET	BURIMET FINANCIARE	PROGRAMI	VLERA E PËRGJITHSHME E E PROJEKTIT (total)	MJETE TË REALIZUARA	PARTNER NË IMPLEMENTIM	SHFRYTËZUES	INDIKATOR/Ë
Prioriteti 1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale								
1.1.1	Nxitja e shpirtit sipërmarrës tek të rinjtë e posaçërisht tek gratë përmes trajnimeve dhe mbështetjes TIK dhe start-up bizneseve të reja	Nuk ka aktivitete të realizuara						
	Nuk ka aktivitete të realizuara							

1.1.2	Krijimi i një rrjeti informativ për zhvillim të inovacioneve në rajon	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.1.3	Nxitja e unioneve dhe formimi i klasterave	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes qendra/ që vepron si ndërmjetësuese rajonal me FIZHT	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim		67.200	67.200	FIZHT	Kompani na RPJP	100 kompani janë kontaktuar për mundësit që ka FIZHT, u organizuan 5 info sesion online
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes qendra / mbështetje teknike dhe informimi i sektorit të biznesit për thirrjet aktive	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal	67.200	67.200	Njësia e projektit, Donator	Kompani na RPJP	100 kompani janë kontaktuar për mundësit e financimit
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes qendra/ programi i vauçerave për rritjen e kapacitetit të biznes sektorit	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal	300.000	177.550	FIZHT	Kompani na RPJP	13 kompani kanë marrë ndihmë me mentor për të aplikuar tek FIZHT
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes qendra/ publikon lisën e burimeve për financim si nga qeveria ashtu edhe të burimeve të tjera për financimin e biznes sektorit	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal	67.200	67.200	Komunat, sektori i biznesit në RPJP	Kompani individuale të interesuara në RPJP	Janë publikuar 12 thirrje nga institucionet qeveritare dhe 26 institucione nga sektori civile dhe sektori privat

1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes Qendra/ Informimi i biznese të cilat janë të themeluara dhe menaxhohen nga femra me mundësi të veçanta për financim	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal	67.200	67.200	Komunat, sektori i biznesit në RPJP	Kompani të interesuar dhe persona nga RPJP	Janë kontaktuar 50 firma për mundësit e veçanta për financim
1.1.5	Brendimi i produkteve dhe shërbimeve që janë të njohura për rajonin.	Nuk ka aktivitete të realizuara							
<b>Prioriteti 1.2 Fuqizimi dhe modernizimi i sektorit të NVM-ve</b>									
1.2.1	Nxitja e iniciativave për ndryshime strukturore tek sektori i NVM në rajon	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.2.2	Nxitja e specializimit të mençur për zhvillimin ekonomik të rajonit	Përkrahja e QZHRPJP/ trajnim për smart specializim	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal faza e 2 -realizim	27.000	25.649	Komunat, sektori i biznesit në RPJP	Komunat dhe sektori i biznesit	Pjesmarrja e 20 përfaqësuesve nga rajoni
1.2.3	Ruajtja e zejeve tradicionale dhe zhvillimi i bizneseve në zona rurale	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.2.4	Nxitja e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet subjekteve brenda vendit dhe jashtë	Biznes qendra/ promovimi i sipërmarrësve të suksesshëm nga rajoni përmes përgatitjes të video klipeve dhe të publikuara në rrjetet sociale	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal faza e 2 -realizim	120.000	120.000	Komunat, Biznes sektori në RPJP	NVM në RPJP	U përgatiten 5 video klime me sipërmarrës të suksesshëm

1.2.4	Nxitja e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet subjekteve brenda vendit dhe jashtë	Bizes qendra / Inicimi dhe vendosja e bashkëpunimit me Oden ekonomike, akselerator, universitet Бизнес	MLS/ SDC/ Projekti ZHQIBR – faza e 2 në realizim	Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal faza e 2 -realizim	67.200	67.200	Odat ekonomike rajonale, universitetet	Sektori i biznesit në RPJP	Nxitja e bashkëpunimit me dy oda ekonomike rajonale dhe 2 universitete
1.2.5	Nxitja e sipërmarrjes tek gratë	Nuk ka aktivitete të realizuara							
<b>Prioriteti 1.3 Rritja e investimeve në rajon</b>									
1.3.1	Mapimi i potencialeve investuese në rajon	Nuk ka aktivitete të realizuara							
